



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 27 janar 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Veselit dhe Krasniqit për Leje për Apelim të Urdhrit të
Parë Gojor të 5 dhjetorit 2024**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të nenit 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 dhjetor 2024, gjatë marrjes në pyetje nga gjykata të W04401-shit, Mbrojtja e Kadri Veselit ("Mbrojtja e Veselit") kundërshtoi përdorimin nga Trupi Gjykses të një pjese të transkriptit të intervistës së një dëshmitari (përkatësisht, "dëshmitari" dhe "intervista e dëshmitarit") me Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS"),¹ mbi bazën se ZPS-ja nuk synon më të thërrasë dëshmitarin për të dëshmuar.²
2. Më 5 dhjetor 2024, Trupi Gjykses lëshoi urdhër gojor ku hodhi poshtë kundërshtimin e Mbrojtjes së Veselit ("Vendimi i Kundërshtuar").³
3. Më 12 dhjetor 2024, Mbrojtja e Veselit dhe Mbrojtja e Jakup Krasniqit (bashkërisht "Mbrojtja") dorëzuan kërkesë për leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar ("Kërkesa").⁴
4. Më 13 janar 2025, me autorizimin e Trupit Gjykses,⁵ ZPS-ja dorëzoi përgjigje ndaj Kërkesës ("Përgjigja").⁶

¹ *Shih* transkriptin e seancës, 4 dhjetor 2024, f. 23411-23413, që i referohet 078019-TR-ET Pjesa 3 RED, f. 17.

² Transkripti i seancës, 4 dhjetor 2024, f. 23431-23432, konfidencial.

³ Transkripti i seancës, 5 dhjetor 2024, f. 23435-23437, konfidencial.

⁴ F02777, Mbrojtja, Kërkesë e Veselit dhe Krasniqit për Leje për Apelim të Urdhrit të Parë Gojor të 5 Dhjetorit 2024, 12 dhjetor 2024, konfidenciale.

⁵ F02800, Trupi Gjykses, Urdhër për Zgjatjen e Afateve për Parashtrime dhe Rishikimin e Transkripteve të Seancave Private gjatë Periudhës së Pushimit Dimëror të Gjykatës, 19 dhjetor 2024, para. 14-15(b).

⁶ F02825, Prokurorja e Specializuar, Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Kërkesave të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Urdhrave Gojorë të 4 dhe 5 dhjetorit 2024, 13 janar 2025, konfidenciale.

5. Më 20 janar 2025, Mbrojtja dorëzoi kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes (“Kundërpërgjigja”).⁷

II. PARASHTRIMET

6. Mbrojtja kërkon leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar lidhur me dy pikat e mëposhtme (bashkërisht, “pikat”):

1. Nëse përfshirja në dokumentacionin e çështjes e dëshmisë që është përjashtuar shprehimisht nga provat e ZPS-së, përmes marrjes në pyetje nga gjykata, uzurpon në mënyrë të palejueshme dhe të padrejtë rolin e ZPS-së (“pika e parë”); dhe
2. Nëse [Trupi Gjykses] gaboi kur nuk mori parasysh dëmin e dukshëm dhe të pashmangshëm që buron nga pamundësia e Mbrojtjes për të marrë në pyetje dhënësin e deklaratës së dëshmitarit, i cili nuk do të thirret si dëshmitar por dëshmia e të cilit (apo pjesë e saj) është përfshirë në dokumentacionin e çështjes si pasojë e përdorimit të saj gjatë marrjes në pyetje nga gjykata (“pika e dytë”).⁸

7. Mbrojtja parashtrohet se pikat në fjalë përmbushin kriteret për leje pasi: (i) burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar dhe nuk janë thjesht mospajtime me të;⁹ (ii) mund të ndikojnë ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit duke uzurpuar rolin e Prokurorisë;¹⁰ dhe (iii) kërkojnë vendim të menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit për t’i kontribuar thelbësisht procesit gjyqësor.¹¹

8. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesa duhet të rrëzohet sepse nuk përmbush standardin e lejes për apelim.¹² ZPS-ja argumenton se kërkesa duhet të rrëzohet bazuar vetëm në arsyen se Trupi Gjykses dhe Paneli i Gjykatës së Apelit kanë trajtuar gjerësisht dhe rrëzuar tashmë pikat lidhur me kuadrin dhe mënyrën e marrjes në pyetje nga

⁷ F02841, Mbrojtja, *Kundërpërgjigje e Veselit dhe Krasniqit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë lidhur me Parashtrimin F02777 (F02825)*, 20 janar 2025, konfidenciale.

⁸ Kërkesa, para. 2, 33.

⁹ Kërkesa, para. 10-27.

¹⁰ Kërkesa, para. 10, 28-30.

¹¹ Kërkesa, para.10, 31.

¹² Përgjigja, para. 1, 7, 14, 16.

gjykatësit.¹³ ZPS-ja pretendon se pikat nuk janë të apelueshme.¹⁴ ZPS-ja argumenton më tej që Mbrojtja nuk demonstroi se: (i) pikat do të ndiknin ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit;¹⁵ dhe se (ii) një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit do t'i kontribuonte thelbësisht procesit gjyqësor.¹⁶

9. Mbrojtja kundërpërgjigjet se: (i) mënyra e kundërshtuar e marrjes në pyetje nga gjykata shkel kufizimet e vendosura në lidhje me të nga Paneli i Gjykatës së Apelit;¹⁷ dhe (ii) keqinterpretimi i pretenduar nga ana e Trupit Gjykues mund të trajtohet vetëm nëpërmjet shqyrtimit në apel.¹⁸ Për rrjedhojë, Mbrojtja kërkon që Trupi Gjykues të miratojë lejen për apelimin e pikave.¹⁹

III. DISPOZITAT LIGJORE PÛRKATËSE

10. Në bazë të nenit 45(2) dhe rregullës 77(2), e drejta për apel lind vetëm nëse përmbushet standardi për miratimin e lejes për apel i përcaktuar në këto dispozita. Rregulla 77(2) përcakton se:

Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të cilën, një vendim i menjëhershëm nga ana e panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në procesin gjyqësor.

11. Trupi Gjykues përfshin përmes referimit dispozitat ligjore përkatëse për standardin e miratimit të lejes për apelim përcaktuar në vendime të mëparshme.²⁰

¹³ Përgjigjja, para. 2, 7, poshtëshënimet 7, 9, 22-23.

¹⁴ Përgjigjja, para. 8-9.

¹⁵ Përgjigjja, para. 10, 12.

¹⁶ Përgjigjja, para. 13.

¹⁷ Kundërpërgjigjja, para. 2-7.

¹⁸ Kundërpërgjigjja, para. 7-10.

¹⁹ Kundërpërgjigjja, para. 11.

²⁰ *Shih* F01237, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë*, 30 janar 2023, para. 7-8; KSC-BC-2020-07,

IV. DISKUTIM

12. Në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses konstatoi se Mbrojtjes apo të drejtave të të akuzuarve nuk iu shkaktua asnjë dëm kur Trupi Gjykses përdori intervistën e dëshmitarit gjatë pyetjeve të gjykatësve, duke marrë parasysh se: (i) sipas interpretimit të Panelit të Gjykatës së Apelit, korniza ligjore e Dhomave të Specializuara nuk vë kufizime mbi temën e pyetjeve për dëshmitarët nga Trupi Gjykses;²¹ (ii) në përputhje me Urdhrin mbi Zhvillimin e Gjykimit,²² ZPS-ja ka njoftuar si duhet palët dhe pjesëmarrësit se nuk synon ta thërrasë dëshmitarin për të dëshmuar;²³ (iii) Mbrojtja e ka pasur intervistën e dëshmitarit për një kohë të gjatë dhe rrjedhimisht, njihet me të;²⁴ dhe (iv) Mbrojtja kishte mundësinë t'i bënte pyetje të mëtejshme W04401-shit për aspekte që buronin drejtpërdrejt nga përdorimi i intervistës së dëshmitarit prej Trupit Gjykses.²⁵ Në atë kohë, Trupi Gjykses nuk kishte marrë ende vendim mbi kërkesën e ZPS-së për ta tërhequr dëshmitarin në fjalë.

13. Paraprakisht, Trupi Gjykses rikujton se, siç ka konstatuar Paneli i Gjykatës së Apelit²⁶ dhe në përputhje me jurisprudencën e njohur penale ndërkombëtare,²⁷

F00423, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesat e Prokurorisë për Leje për Apelim të Vendimit F00413 dhe Efekt Pezullues*, 8 nëntor 2021, para. 13-21; F00372, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt për Leje për Apelim të Urdhrit F00328*, 15 tetor 2021, para. 15-17; F00484, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit F00470*, 8 dhjetor 2021, para. 4-14. Shih gjithashtu F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel* ("Vendimi mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel"), 11 janar 2021, para. 6-7, 9-17.

²¹ Transkripti i seancës, 5 dhjetor 2024, f. 23435-23436, konfidencial, që i referohet IA028/F00011, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Thaçit, Selimit dhe Krasniqit kundër Urdhrit Gojor mbi Marrjen në Pyetje nga Trupi Gjykses* ("Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Marrjen në Pyetje nga Trupi Gjykses"), 4 korrik 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua të njëjtën ditë, IA028/F00011/RED).

²² Transkripti i seancës, 5 dhjetor 2024, f. 23436, konfidencial, që i referohet F01226/A01, Urdhër mbi Zhvillimin e Gjykimit, 25 janar 2023, para. 48.

²³ Transkripti i seancës, 5 dhjetor 2024, p. 23436, konfidencial.

²⁴ Transkripti i seancës, 5 dhjetor 2024, p. 23436, konfidencial.

²⁵ Transkripti i seancës, 5 dhjetor 2024, p. 23436, konfidencial.

²⁶ Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Marrjen në Pyetje nga Trupi Gjykses, para. 10.

²⁷ Shih, *p.sh.*, ICTY, *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-A, Appeals Chamber, *Judgment* ("[Popović Judgment](#)"), 30 January 2015, para. 205; *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-AR73.3, Appeals Chamber, *Decision on Appeals Against Decision on Impeachment of a Party's Own Witness*, 1 February 2008, para. 12; *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-AR73.4, Appeals Chamber, *Decision on Prosecution Appeal Concerning*

vendimet lidhur me aspekte të administrimit të gjykimit dhe zhvillimin e procesit, përfshirë modalitetet e marrjes në pyetje të dëshmitarëve, përgjithësisht duhet të trajtohen si diskrecionale.²⁸ Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se Paneli i Gjykatës së Apelit ka vënë në dukje konkretisht se Trupi Gjykses nuk është i detyruar ta respektojë rregullën 143(3) të Rregullores, e cila vlen për marrjen në pyetje të dëshmitarëve nga palët.²⁹ Paneli i Gjykatës së Apelit ka përmendur gjithashtu kompetencën diskrecionale të gjerë të Trupit Gjykses që t'u bëjë dëshmitarëve *çfarëdo* pyetje që e gjykon të nevojshme për qartësimin e dëshmimeve të tyre ose për zbulimin e së vërtetës.³⁰ Në fund, Trupi Gjykses vëren se, kur trajtoi një ankesë të mëparshme të Mbrojtjes se Trupi Gjykses kishte përdorur një dokument të papranuar si provë gjatë pyetjeve të gjykatësve, Paneli i Gjykatës së Apelit bëri të qartë se “edhe pse dokumentet e përdorura nga Trupi Gjykses gjatë marrjes në pyetje nuk ishin paraqitur për pranim si prova nga palët, Paneli vë në dukje se, duke pasur parasysh kompetencën e Trupit Gjykses për të pranuar prova që vlerësohen të nevojshme, kjo marrje në pyetje mund të jetë relevante për shqyrtimin e besueshmërisë dhe pranueshmërisë së dokumenteve”.³¹

A. PIKA E PARË

14. Mbrojtja parashtroi se: (i) vendimi i Panelit të Gjykatës së Apelit për marrjen në pyetje nga Trupi Gjykses, në fakt, vë kufizime mbi pyetjet e gjykatësve, duke qenë se pyetjet duhet të mos krijojnë përshtypjen e anësisë, pësimin e dëmit, ose të shkelin të drejtat e të akuzuarit;³² (ii) kundërshtimet e Mbrojtjes së Veselit

the Trial Chamber's Ruling Reducing Time for the Prosecution Case, 6 February 2007, para. 8, with further references; ICTR, *Nahimana et al. v. Prosecutor*, ICTR-99-52-A, Appeals Chamber, *Judgment* (“*Nahimana Judgment*”), 28 November 2007, para. 182.

²⁸ *Shih, veçanërisht, Popović Judgment*, para. 205; *Nahimana Judgment*, para. 182.

²⁹ Vendimi i Gjykatës së Apelit mbi Marrjen në Pyetje nga Trupi Gjykses, para. 32.

³⁰ Po aty, theksimi i shtuar.

³¹ Po aty, para. 47.

³² Kërkesa, para. 11, që i referohet Vendimit të Gjykatës së Apelit mbi Marrjen në Pyetje nga Trupi Gjykses, para. 32.

kishin të bënin me përdorimin gjatë marrjes në pyetje nga gjykata të deklaratave të papranueshme të dëshmitarëve, jo me temën e pyetjeve;³³ (iii) riparaqitja e dëshmisë së përjashtuar të dëshmitarit përmes një dëshmitari tjetër përbën shkelje të rëndë të të drejtave themelore të të akuzuarve dhe uzurpon rolin e ZPS-së;³⁴ (iv) përdorimi i dëshmisë së dëshmitarit dallon nga përdorimi i provave të tjera, si për shembull, artikujve të gazetave;³⁵ dhe (v) Trupit Gjykues nuk duhet t'i lejohet të bëjë atë që ZPS-së do t'i ishte ndaluar të bënte.³⁶

15. ZPS-ja përgjigjet se pika e parë përsërit argumentet e paraqitura para Trupit Gjykues dhe kufizon kompetencën e gjykatësve për t'u bërë pyetje dëshmitarëve, në kundërshtim me formulimin e qartë të Rregullores.³⁷

16. Mbrojtja kundërpërgjigjet se Përgjigjja shtrembëron argumentet e ngritura në Kërkesë.³⁸ Në veçanti, Mbrojtja shprehet se pikat: (i) burojnë nga interpretimi dhe zbatimi i gabuar i vendimit të Dhomës së Gjykatës së Apelit nga ana e Trupit Gjykues;³⁹ (ii) i shkaktojnë dëm të pariparueshëm Mbrojtjes, që ZPS-ja e ka të ndaluar me ligj;⁴⁰ (iii) shkaktojnë rrezikun që një vëzhgues i arsyeshëm të krijojë përshtypjen e anësisë së Trupit Gjykues;⁴¹ dhe (iv) duhet të vendosen nga një tribunal i paanshëm.⁴²

17. Trupi Gjykues rikujton konstatimet e bëra në Vendimin e Kundërshtuar.⁴³ Në veçanti, Trupi Gjykues theksoi se, “në ushtrimin e kompetencave diskrecionale të gjera për t'u bërë çfarëdo pyetje dëshmitarëve, Trupit Gjykues nuk i ndalohet të përdorë dokumente apo deklarata që lidhen me persona që nuk janë më në listën

³³ Kërkesa, para. 11.

³⁴ Kërkesa, para. 12-15, 17-18.

³⁵ Kërkesa, para. 16.

³⁶ Kërkesa, para. 19.

³⁷ Përgjigjja, para. 8, që i referohet rregullës 127(3).

³⁸ Kundërpërgjigjja, para. 2.

³⁹ Kundërpërgjigjja, para. 3. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen, para. 7, 9.

⁴⁰ Kundërpërgjigjja, para. 4. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen, para. 9.

⁴¹ Kundërpërgjigjja, para. 5. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen, para. 8.

⁴² Kundërpërgjigjja, para. 10.

⁴³ *Shih më lart*, para. 12.

e dëshmitarëve të palëve, me kusht që asnjë palë të mos dëmtohet nga përdorimi i dokumentit dhe të respektohen të drejtat e të akuzuarve”.⁴⁴ Lidhur me këtë, Trupi Gjykses është i mendimit se, në kundërshtim me argumentet e ZPS-së,⁴⁵ nëse përfshirja në dokumentacionin e çështjes përmes marrjes në pyetje nga gjykata e informacionit nga intervista me një dëshmitar që ZPS-ja nuk synon më ta thërrasë për të dëshmuar përbënte shkelje të rëndë të të drejtave të të akuzuarve dhe uzurponte rolin e ZPS-së – është një temë më vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se pika e parë e Mbrojtjes buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

18. Lidhur me ndikimin e ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjykimit, Trupi Gjykses vëren se pyetja nëse Trupit Gjykses i kufizohet lloji i materialit ku mund të mbështetet gjatë pyetjeve të gjykatësve dhe në qoftë se po, nëse përdorimi nga Trupi Gjykses i intervistës së dëshmitarit përbënte shkelje të rëndë të të drejtave të të akuzuarve dhe uzurpoi rolin e ZPS-së, bazuar në faktin se ZPS-ja nuk synon më ta thërrasë dëshmitarin për të dëshmuar, mund të ndikojë ndjeshëm në të drejtat e të akuzuarve për gjykim të drejtë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se, në kundërshtim me parashtrimet e ZPS-së,⁴⁶ Mbrojtja ka demonstruar se pika e parë do të ndikonte në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit.

19. Lidhur me nëse një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit mund t’i kontribuojë thelbësisht procesit gjyqësor, Trupi Gjykses e vlerëson me rëndësi për kryerjen e drejtë të procesit dhe të drejtat e të akuzuarve që të ketë qartësi lidhur me pyetjen nëse Trupit Gjykses i kufizohet lloji i materialit ku mund të mbështetet gjatë pyetjeve të gjykatësve, dhe në qoftë se po, nëse përdorimi nga Trupi Gjykses i intervistës së dëshmitarit përbënte shkelje të rëndë të të drejtave

⁴⁴ Transkripti i seancës, 5 dhjetor 2024, f. 23436, konfidencial.

⁴⁵ Përgjigja, para. 1-2, 7-9, 14-16.

⁴⁶ Përgjigja, para. 10, 12.

të të akuzuarve dhe uzurpoi rolin e ZPS-së, bazuar në faktin se ZPS-ja nuk synon më ta thërrasë dëshmitarin për të dëshmuar. Në kundërshtim me parashtrimet e ZPS-së,⁴⁷ Trupi Gjykses është bindur se një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit për pikën e parë do t'i kontribuojë thelbësisht procesit gjyqësor.

20. Për arsyet sa më lart, Trupi Gjykses miraton lejen për apelimin e pikës së parë.

B. PIKA E DYTË

21. Mbrojtja pretendon se në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses nuk vlerësoi si duhet dëmin që shkaktohet nga pamundësia e Mbrojtjes për të marrë në pyetje dhënësin e deklaratës në rrethana kur dëshmia e atij personi përfshihet në transkriptin e procesit dhe një pale të tretë i kërkohet ta komentojë atë.⁴⁸ Mbrojtja argumenton se: (i) Trupi Gjykses nuk zbatoi arsyetimin e vet kur lejoi që dëshmitarit t'i paraqiten dokumente, me çka Mbrojtjes i shkaktohet dëm i qartë dhe i pariparueshëm;⁴⁹ (ii) në rolin e vet si arbitër i paanshëm, Trupi Gjykses nuk duhet të ndërmarrë veprime që dëmtojnë një palë;⁵⁰ dhe (iii) fakti që Mbrojtja ka pasur deklaratën e dëshmitarit për një kohë të gjatë dhe mundësinë për ta marrë në pyetje W04401-shin, nuk riparson dëmin që i shkaktohet Mbrojtjes nga pamundësia për ta marrë në pyetje dëshmitarin.⁵¹

22. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja nuk demonstroi se pika e dytë është e apeluarshme pasi: (i) argumentet e Mbrojtjes lidhur me pamundësinë për t'i bërë pyetje dëshmitarit në fjalë ngatërrojnë përdorimin nga Trupi Gjykses të deklaratës së tij të dëshmitarit për të marrë dëshmi nga W04401 me vlerën provuese të

⁴⁷ Përgjigja, para. 13.

⁴⁸ Kërkesa, para. 20.

⁴⁹ Kërkesa, para. 21.

⁵⁰ Kërkesa, para. 22. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 23-24.

⁵¹ Kërkesa, para. 26-27. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 25.

pavarur të pretenduar të deklaratës;⁵² (ii) Trupi Gjykses shqyrtoi siç duhet parashtrimet e Mbrojtjes dhe i vlerësoi të pabazuara;⁵³ dhe (iii) Mbrojtja thjesht nuk pajtohet me vlerësimin e Trupit Gjykses dhe nuk vërteton ndonjë gabim faktik.⁵⁴

23. Mbrojtja kundërpërgjigjet se është shkelur e drejta e Mbrojtjes për të ballafaquar provat kundër të akuzuarve, pasi sugjerimi se Mbrojtja mund të marrë në pyetje një palë të tretë në lidhje me fjalët e një dëshmitari tjetër keqkupton dhe shtrembëron llojin e dëmit.⁵⁵

24. Trupi Gjykses rikujton se në Vendimin e Kundërshtuar konstatoi se përdorimi prej Trupit Gjykses i intervistës së dëshmitarit gjatë pyetjeve të gjykatësve nuk i shkaktoi dëm Mbrojtjes apo të drejtave të të akuzuarve.⁵⁶ Për të mbërritur në këtë konstatim, Trupi Gjykses mori parasysh, ndër të tjera, faktet që: (i) ZPS-ja ka njoftuar se nuk synon ta thërrasë dëshmitarin për të dëshmuar dhe Trupi Gjykses nuk ka marrë ende vendim në lidhje me këtë; (ii) Mbrojtja e ka pasur intervistën e dëshmitarit për një kohë të gjatë; dhe (iii) Mbrojtja kishte mundësinë t'i bënte pyetje të mëtejshme W04401-shit për aspekte që buronin drejtpërdrejt nga përdorimi i intervistës së dëshmitarit prej Trupit Gjykses.⁵⁷ Lidhur me këtë, Trupi Gjykses është i mendimit se, në kundërshtim me argumentet e ZPS-së,⁵⁸ nëse Trupi Gjykses gaboi në vlerësimin e vet të dëmit që shkaktohet nga pamundësia e Mbrojtjes për të marrë në pyetje dhënësin e deklaratës së dëshmitarit, i cili mund të mos thirret më si dëshmitar por dëshmia e incizuar e të cilit është përdorur gjatë pyetjeve të gjykatësve – është një temë më

⁵² Përgjigjja, para. 9.

⁵³ Përgjigjja, para. 9.

⁵⁴ Përgjigjja, para. 9.

⁵⁵ Kundërpërgjigjja, para. 6. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen, para. 9.

⁵⁶ *Shih më lart*, para. 12.

⁵⁷ *Shih më lart*, para. 12.

⁵⁸ Përgjigjja, para. 1-2, 7-9, 14-16.

vete që buron nga Vendimi i Kundërshtuar. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton se pika e dytë buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

25. Lidhur me ndikimin e ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjykimit, Trupi Gjykses vëren se pyetja nëse Trupi Gjykses gaboi në vlerësimin e vet të dëmit që shkaktohet nga pamundësia e Mbrojtjes për të marrë në pyetje dhënësin e deklaratës së dëshmitarit, i cili mund të mos thërritet më si dëshmitar por dëshmia e incizuar e të cilit është përdorur gjatë pyetjeve të gjykatësve - mund të ndikojë ndjeshëm në të drejtat e të akuzuarve për gjykim të drejtë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se, në kundërshtim me parashtrimet e ZPS-së,⁵⁹ Mbrojtja ka demonstruar se pika e dytë do të ndikonte në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit.

26. Lidhur me nëse një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit mund t'i kontribuojë thelbësisht procesit gjyqësor, Trupi Gjykses e gjykon të dobishme për kryerjen e drejtë të procesit dhe të drejtat e të akuzuarve që të ketë qartësi lidhur me pyetjen nëse Trupi Gjykses gaboi në vlerësimin e vet të dëmit të pretenduar. Rrjedhimisht, Trupit Gjykses është bindur se, në kundërshtim me parashtrimet e ZPS-së,⁶⁰ një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit në lidhje me pikën e dytë, do t'i kontribuojë thelbësisht procesit.

27. Për arsyet sa më lart, Trupi Gjykses miraton lejen për apelimin e pikës së dytë.

V. KLASIFIKIMI

28. Trupi Gjykses vëren se Kërkesa, Përgjigjja dhe Kundërpërgjigjja janë dorëzuar si konfidenciale. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se Përgjigjja e ZPS-së është riklasifikuar si publike. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen të

⁵⁹ Përgjigjja, para. 10, 12.

⁶⁰ Përgjigjja, para. 13.

kërkojë riklasifikimin e Kërkesës dhe Kundërpërgjigjes, ose të dorëzojë versionet e redaktuara publike të tyre, deri **të premten, 31 janar 2025**.

VI. VENDIM

29. Për arsyet e sipërpërmendura, Trupi Gjykues:

- a) **MIRATON** lejen për apelimin e pikës së parë dhe të dytë; dhe
- b) **URDHËRON** Mbrojtjen të kërkojë riklasifikimin e Kërkesës dhe Kundërpërgjigjes, ose të dorëzojë versionet e redaktuara publike të tyre, deri **të premten, 31 janar 2025**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E hënë, 27 janar 2025

Në Hagë, Holandë.